



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DHOMA E NOTERËVE TIRANE  
NR. 3307 REP.  
NR. 1691 KOL.

**AKT THEMELIMI**  
**I SHOQERISE "ALSION ABRA" SH.P.K**

Sot me date 30.07.2019 u paraqiten personat FIZIK si me poshte:

**Z. Ajet Ramçaj**, atesia Elez, i datelindjes 08.05.1968, lindur ne Koplík dhe banues ne Tirane, madhor, me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar, i identifikuar prej leternjoftimit me nr. personal G80508141T,  
**Znj. Bojana Ramçaj**, atesia Avni, e datelindjes 24.06.1971, lindur ne Elbasan dhe banuese ne Tirane, madhore me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar, e identifikuar prej leternjoftimit me nr. personal H15624056J,  
**Z. Ajan Ramçaj**, atesia Ajet, i datelindjes 12.09.1998, lindur ne Elbasan dhe banues ne Tirane, madhor, me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar, i identifikuar prej leternjoftimit me nr. personal J80912066K.

Sipas Legjislacionit Shqiptar ne pergjithesi, personat fizik te mesiperem, kane vendosur si me poshte:

**KREU I**

**Emertimi, Selia dhe afati i Shoqerise**

**Neni 1**

Te themelojne shoqerine me pergjegjesi te kufizuar, per te zhvilluar veprimtari private. Shoqeria eshte person juridik Shqiptar, veprimtaria e te ciles rregullohet nga kjo kontrate, Statuti i saj dhe Legjislacioni ne fuqi.

**Neni 2**

Shoqeria do te emertohet **"ALSION ABRA" SH.P.K.**

**Neni 3**

Shoqeria do te kete Seline e saj ne objektin e pershkruar me poshte:  
**Tirane, Rruga Sami Frasheri, Pallati 20/10, Ap. Nr. 3.**

**Neni 4**

Shoqeria do te zhvilloj aktivitetin e saj me afat te pakufizuar.  
Shoqeria **"ALSION ABRA" SH.P.K.** gezon statusin e personit juridik shqiptar nga momenti i regjistrimit si e tille ne regjistrin e QKB-se.

---

**Neni 5**

**Shoqeria "ALSION ABRA" SH.P.K. do te kete si objekt aktiviteti:**

Investitor privat ne fushen e ndertimit te objekteve te ndryshme civile private e shtetore, social kulturore dhe agjenci per shitblerjen e ketyre ndertimeve. Projektim, zbatim dhe ndertim te objeteve sociale, kulturore, industriale etj. Ndertim godina banimi si me fondet e vete shoqerise ashtu dhe fonde publike dhe kredi bankare. Ndertime me karakter social, kulturore dhe te kulteve te ndryshme fetare si dhe restaurime. Ndertime dhe riasfaltime rruges, punime te sinjalizimit rrugore etj.

**Shoqeria ne ushtrimin e aktivitetit te saj, do te marre te gjitha autorizimet e lejet e nevojshme prane institucioneve publike shqiptare, dhe do te mbeshtetet ne rregullat dhe normat ne fuqi ne lidhje me ushtrimin e veprimtarise se saj te rregullt ekonomik.**

**Neni 6**

Shoqeria do te ushtroje aktivitetin e saj mbi baze dege ne qytete te tjera te vendit, te cilat do te hapen pasi te kete filluar aktiviteti i shoqerise.

**Neni 7**

Selia e shoqerise mund te transferohet.

**KREU II  
KAPITALI**

**Neni 8  
Kapitali themeltar**

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 100.000 lekë

Kapitali i mesiperm eshte i nenshkruar nga "ortaket" e shoqerise:

**Z. Ajet Ramçaj**, zoterues i 1 (një) kuote, me vlere të pergjithshme 50.000 lekë që përbën 50% te kapitalit themeltar te shoqerise.

**Znj. Bojana Ramçaj**, zoteruese e 1 (një) kuote, me vlere të pergjithshme 25.000 lekë që përbën 25% te kapitalit themeltar te shoqerise.

**Z. Ajan Ramçaj**, zoterues i 1 (një) kuote, me vlere të pergjithshme 25.000 lekë që përbën 25% te kapitalit themeltar te shoqerise.

Pjesët e kapitalit themeltar nuk mund të përfaqësohen nga letra me vlere të tregtueshme.

Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta)

---

*Shoqeri*

*[Signature]*

---

Ortaku përgjigjet për humbjet e shoqërisë përkundrejt të tretëve deri në vlerën e kontributit të tij në kapitalin themeltar të shoqërisë; Kapitali i shoqërisë do të hidhet në Bankë pasi të dali NIPT i shoqërisë.

**Neni 9**  
**Transferimi i kapitalit**

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.

Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë përgjigjen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e regjistrimit të kalimit të saj në Qendrën Kombëtare të Biznesit, sipas nenit 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit". Regjistrimi i kalimit të kuotave ka efekt deklarativ.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

**KREU III**  
**ORGANET VENDIMARRESE DHE DREJTUESE**

**Neni 10**  
**Organi Vendimmarrës**

Asambleja e përgjithshme është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë.

Asambleja e përgjithshme është organi vendimmarrës i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të percaktuara në ligj. Çdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKR për të pasqyruar ndryshimet në skedën e shoqërisë.

Asambleja e përgjithshme, vendos për çështje si:

- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
- b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- c) emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;

---

*Shouy*

*Margalina Dauti*

- 
- c) përcaktimin e shpërblimeve
  - d) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecuresë së veprimtarisë;
  - e) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
  - f) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;

Të gjitha vendimet e marra nga ortaku i vetëm regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen. Duhet regjistruar në veçanti, por pa u kufizuar në to, vendimet për:

- a) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecuresë së veprimtarisë;
- b) shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
- c) investime;
- c) vendimet për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme. Shoqëria nuk mund t'i kundrejtojë pavlefshmërinë të tretit, që ka fituar të drejta në mirëbesim, përveç rastit kur shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmërinë, apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të.

#### **Neni 11** **Administrimi**

Administrator i shoqërisë është **Z.Ajet Ramçaj**, atesia Elez, i datelindjes 08.05.1968, lindur ne Koplik dhe banues ne Tirane, madhor, me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar, i identifikuar prej leternjoftimit me nr. personal G80508141T, emeruar në këtë detyrë për një afat 5 vjecar me të drejtë ripertitje.

Administratori emërohet dhe shkarkohet me vendim të Asamblese se përgjithshme të ortakëve të shoqërisë.

#### **Neni 12** **Kompetencat**

Administratori ka të drejtë e detyrohet të:

- a) kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) përfaqësojë shoqërinë tregtare;
- c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;

- c) përgatiti dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
- d) krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- dh) kryejë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- e) raportojë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;

Administratori është i detyruar të thërrasi mbledhjen e ortakut të vetem edhe në rastet kur :

sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim dhe kur shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara,

Administratori ka të drejte të kryejë të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm e të jashtëzakonshëm. Administratori përfaqëson Shoqërinë përpara të gjitha personave fizike e juridike, publike dhe/ose private vendas apo të huaj, autoriteteve shtetërore Shqiptare apo të huaja, përfshi këtu autoritetet gjyqësore të gjitha shkalleve. Administratori ka të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretët në emër të shoqërisë, në të gjitha rrethanat me përjashtim të kompetencave që ligji ia jep shprehimisht ortakeve të shoqërisë.

Administratori angazhon shoqërinë në marrëdhëniet me të tretët nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e saj.

Shoqëria nuk merr përsipër pasojat ndaj të tretëve kur ajo provon se të tretët e dinin që akti i administratorit e kalonte objektin e shoqërisë ose kur të tretët nuk mund ta injoronin këtë akt në rrethanat e dhëna, duke patur parasysh faktin se vetëm shpallja e statutit nuk është provë e mjaftueshme.

### **Neni 13** **Viti Financiar**

Viti financiar i Shoqërisë fillon më 1 Janar dhe përfundon më 31 Dhjetor. Përjashtimisht, viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në QKB dhe mbyllet më 31 Dhjetor.

### **Neni 14**

Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të bëhet në cdo kohë:

- a) kur mbaron kohëzgjatja, për të cilën është themeluar;
- b) me përfundimin e procedurave të falimentimit apo në rast të pamjaftueshmërisë së pasurive për të mbuluar shpenzimet e procedurës së falimentimit;





c) në rast se objekti bëhet i paralizueshëm për shkak të mosfunksionimit të vazhduar të organeve të shoqërisë apo për shkaqe të tjera që e bëjnë absolutisht të pamundur vazhdimin e veprimtarisë tregtare;

ç) në rastet e pavlefshmërisë së themelimit të shoqërisë, të parashikuara nga neni 3/1 i këtij ligj;

d) në raste të tjera, të parashikuara në statut;

dh) në raste të tjera, të parashikuara me ligj;

e) për çdo shkak tjetër të vendosur nga asambleja e ortakëve.

Në këtë rast Asambleja e përgjithshme merr vendim me shkrim në të cilin parashikon mënyrën e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shenuar në çdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emërtesën shtesë "Shoqëri në likuidim e sipër".

### **Neni 15 Baza Ligjore**

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e tij në përputhje të plotë me këtë akt themelimi dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Për sa nuk parashikohet në këtë akt themelimi, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

### **Neni 16 Dispozita përfundimtare**

Ky akt themelimi u redaktua në 4 ekzemplarë në gjuhën shqipe, me përmbajtje dhe vlera të njejta juridike.

Akti i mësipërm pasi miratohet në parim dhe nen për nen nga Ortakët themelues të shoqërisë tregtare "ALSION ABRA" Sh.p.k nënshkruhet në të gjitha kopjet duke vendosur emrin, mbiemrin dhe firmën e tij orgjinale.

Unë, Noterja ia lexova këtë Akt Themelimi me zë të lartë palëve, të cilat e gjetën atë në përputhje të plotë me vullnetin e tyre. Ky Akt Themelimi nënshkruhet lirisht nga palët në praninë time, dhe unë Noterja, vërtetoj nënshkrimet e tyre sipas ligjit.

#### **ORTAKËT**

**AJET RAMÇAJ**

*Ajet Ramçaj*

**BOJANA RAMÇAJ**

*Bojana Ramçaj*

**AJAN RAMÇAJ**

*Ajan Ramçaj*

#### **NOTERE**

**MARGALINA Y. DAUTI**



---

**STATUT I SHOQERISE**  
**“ALSION ABRA” SH.P.K**

**KREU I**

**Emertimi, Selia dhe afati i Shoqerise**

**Neni 1**

Te themelojne shoqerine me pergjegjesi te kufizuar, per te zhvilluar veprimtari private. Shoqeria eshte person juridik Shqiptar, veprimtaria e te ciles rregullohet nga kjo kontrate, Statuti i saj dhe Legjislacioni ne fuqi.

**Neni 2**

Shoqeria do te emertohet **“ALSION ABRA” SH.P.K.**

**Neni 3**

Shoqeria do te kete Seline e saj ne objektin e pershkruar me poshte:  
**Tirane, Rruga Sami Frasheri, Pallati 20/10, Ap. Nr. 3.**

**Neni 4**

Shoqeria do te zhvilloj aktivitetin e saj me afat te pakufizuar.

Shoqeria **“ALSION ABRA” SH.P.K.** gezon statusin e personit juridik shqiptar nga momenti i regjistrimit si e tille ne regjistrin e QKB-se.

**Neni 5**

**Shoqeria “ALSION ABRA” SH.P.K. do te kete si objekt aktiviteti:**

Investitor privat ne fushen e ndertimit te objekteve te ndryshme civile private e shtetore, social kulturore dhe agjenci per shitblerjen e ketyre ndertimeve. Projektim, zbatim dhe ndertim te objeteve sociale, kulturore, industriale etj. Ndertim godina banimi si me fondet e vete shoqerise ashtu dhe fonde publike dhe kredi bankare. Ndertime me karakter social, kulturore dhe te kulteve te ndryshme fetare si dhe restaurime. Ndertime dhe riasfaltime rruges, punime te sinjalizimit rrugore etj.

**Shoqeria ne ushtrimin e aktivitetit te saj, do te marre te gjitha autorizimet e lejet e nevojshme prane institucioneve publike shqiptare, dhe do te mbeshtetet ne rregullat dhe normat ne fuqi ne lidhje me ushtrimin e veprimtarise se saj te rregullt ekonomik.**

**Neni 6**

Shoqeria do te ushtroje aktivitetin e saj mbi baze dege ne qytete te tjera te vendit, te cilat do te hapen pasi te kete filluar aktiviteti i shoqerise.

**Neni 7**

Selia e shoqërise mund te transferohet.

**KREU II  
KAPITALI**

**Neni 8  
Kapitali themeltar**

Kapitali themeltar i shoqërise është 100.000 lekë

Kapitali i mësipërm është i nënshkruar nga “ortakët“ e shoqërisë:

**Z. Ajet Ramçaj**, zotërues i 1 (një) kuote, me vlerë të përgjithshme 50.000 lekë që përbën 50% te kapitalit themeltar te shoqërisë.

**Znj. Bojana Ramçaj**, zotëruese e 1 (një) kuote, me vlerë të përgjithshme 25.000 lekë që përbën 25% te kapitalit themeltar te shoqërisë.

**Z. Ajan Ramçaj**, zotërues i 1 (një) kuote, me vlerë të përgjithshme 25.000 lekë që përbën 25% te kapitalit themeltar te shoqërisë.

Pjesët e kapitalit themeltar nuk mund të përfaqësohen nga letra me vlerë të tregtueshme.

Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta)

Ortaku përgjigjet për humbjet e shoqërisë përkundrejt të tretëve deri në vlerën e kontributit të tij në kapitalin themeltar të shoqërisë;

**Neni 9**

**Zmadhimi dhe zvogelimi i kapitalit**

Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet nëpërmjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, dhe në shërbime, nëpërmjet emërimit nga gjykata kompetente e një eksperti të autorizuar për këto kontribute në natyrë sipas kërkesës së administratorit.

Zvogëlimi i kapitalit realizohet me vendim të Asamblesë se përgjithshme të ortakëve në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit. Projekti i zvogëlimit të kapitalit u komunikohet ekspertëve kontabël të autorizuar, në rast se ka të tillë, të paktën 45 ditë përpara datës së mbledhjes së Ortakëve të thirrur për të marrë vendim rreth këtij projekti.

Zvogëlimi i kapitalit themeltar në një vlerë më të vogël se ajo e përcaktuar në nenin 6 të këtij statuti, e bën të detyrueshme marrjen e një vendimi prej shoqërisë për zmadhimin e kapitalit themeltar të paktën deri në vlerën minimale. Në rast moszbatimi të kërkesave të këtij paragrafi, çdo personi interesuar mund të kërkojë në rrugë gjyqësore prishjen e shoqërisë.

---

---

*Bhow*

*[Signature]*



---

Kjo prishje nuk mund të shpallet, në qoftë se rregullimi është bërë në ditën kur gjykata mbliidhet për të marrë vendim.

**Neni 10**  
**Transferimi i kapitalit**

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.

Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë përgjigjen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e regjistrimit të kalimit të saj ne Qendrën Kombëtare të Biznesit, sipas nenit 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit". Regjistrimi i kalimit të kuotave ka efekt deklarativ.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

**KREU III**  
**ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE**

**Neni 11**  
**Organi Vendimmarres**

Asambleja e përgjithshme e Ortakëve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë.

Asambleja e përgjithshme e Ortakëve është organi vendimmarrës i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj. Çdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKB për të pasyqruar ndryshimet në skedën e shoqërisë.

*Asambleja e përgjithshme e Ortakëve, vendos për çështje si :*

- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
- b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- c) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- ç) përcaktimin e shpërblimeve

---





- d) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- e) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- f) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;

Të gjitha vendimet e marra nga ortaku i vetëm regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen. Duhet regjistruar në veçanti, por pa u kufizuar në to, vendimet për:

- a) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- b) shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
- c) investime;
- ç) vendimet për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme. Shoqëria nuk mund t'i kundrejtojë pavlefshmërinë të tretit, që ka fituar të drejta në mirëbesim, përveç rastit kur shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmërinë, apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të.

### **Neni 12 Administrimi**

Administrator i shoqërisë është **Z.Ajet Ramçaj**, atesia Elez, i datëlindjes 08.05.1968, lindur ne Koplik dhe banues ne Tirane, madhor, me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar, i identifikuar prej leternjoftimit me nr. personal G80508141T, emeruar në këtë detyrë për një afat 5 vjecar me të drejtë ripërteritje.

Administratori emërohet dhe shkarkohet me vendim të Asamblese se përgjithshme të ortakëve të shoqërisë.

### **Neni 13 Kompetencat**

Administratori ka të drejtë e detyrohet të:

- a) kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) përfaqësojë shoqërinë tregtare;
- c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- ç) përgatitisi dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;

*Bhary*

*[Signature]*

d) krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;

dh) kryejë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendren Kombetare të Biznesit;

e) raportojë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;

Administratori është i detyruar të thërrasi mbledhjen e ortakut të vetem edhe në rastet kur :

sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezultojnë ose ekzistojnë rreziku që aktivitetet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim dhe

kur shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të asetëve të shoqërisë, që rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare të certifikuar,

Administratori ka të drejtë të kryejë të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm e të jashtëzakonshëm. Administratori përfaqëson Shoqërinë përpara të gjitha personave fizike e juridike, publike dhe/ose private vendas apo të huaj, autoriteteve shtetërore Shqiptare apo të huaja, përfshi këtu autoritetet gjyqësore të gjitha shkallëve. Administratori ka të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretët në emër të shoqërisë, në të gjitha rrethanat me përjashtim të kompetencave që ligji ia jep shprehimisht ortakëve të shoqërisë.

Administratori angazhon shoqërinë në marrëdhëniet me të tretët nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e saj.

Shoqëria nuk merr përsipër pasojat ndaj të tretëve kur ajo provon se të tretët e dinin që akti i administratorit e kalonte objektin e shoqërisë ose kur të tretët nuk mund ta injoronin këtë akt në rrethanat e dhëna, duke patur parasysh faktin se vetëm shpallja e statutit nuk është provë e mjaftueshme.


#### **Neni 14** **Përgjegjësitë**

Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga Ortaket që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakëve që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.

Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit "Per Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", administratori detyrohet:





1. a) të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis;

b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;

c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;

ç) të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personale me ata të shoqërisë;

d) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.

2. Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjen ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.

3. Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkuara. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare.

4. Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit „Per Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, kryen veprimet e mëposhtme:

a) u kthen ortakëve kontributet;

b) u paguan ortakëve interesa apo dividendë;

c) u shpërndan aktivet shoqërisë;

ç) lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;

d) jep kredi.

**Neni 15**  
**Viti Financiar**

Viti financiar i Shoqërisë fillon me 1 Janar dhe përfundon më 31 Dhjetor. Përjashtimisht, viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe mbyllet më 31 Dhjetor.





---

**Neni 16**  
**Bilanci i shoqërisë dhe dividendet**

Brenda 6 muajsh nga mbyllja e vitit financiar, Mbledhja e Ortakëve, miraton bilancin e paraqitur nga Administratori.

Mbledhja e Ortakëve vendos rreth shpërndarjes së dividendit, pasi të jenë zbritur humbjet e vitit të mëparshëm financiar, siç edhe parashikohet nga ligji.

**Neni 17**  
**Ekspertet**

Eksperti ka për detyrë që të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabel të veprimtarisë ekonomiko tregtare të shoqërisë, atë gjithëvjetor dhe atë në lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tillë i ngarkuar nga ana e asamblesë së ortakëve.

Ne përfundim të kontrollit eksperti kontabel i autorizuar përfaqëson raportin me shkrim për nxjerrjen e rezultatit të bilancit financiar vjetor si dhe për kontrollet periodike të ushtruara, të cilat është i detyruar që t'ja paraqesë e dorëzojë në kohë asamblesë së ortakëve për t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazën e të drejtës vendimore që ka.

**Neni 18**

Të ardhurat neto ( Dividenti ) që mbeten pas veçimit të fondeve ligjore të mësipërme dhe të atyre për shlyerjen e çdo detyrimi fiskal apo likuidimin e pagesave ndaj të treta, i mbeten dhe i kalojnë në pronësi, ortakut të vetëm të shoqërisë.

**Neni 19**

Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të bëhet në çdo kohë:

- a) kur mbaron kohëzgjatja, për të cilën është themeluar;
- b) me përfundimin e procedurave të falimentimit apo në rast të pamjaftueshmërisë së pasurive për të mbuluar shpenzimet e procedurës së falimentimit;
- c) në rast se objekti bëhet i përcaktueshëm për shkak të mosfunksionimit të vazhduar të organeve të shoqërisë apo për shkaqe të tjera që e bëjnë absolutisht të pamundur vazhdimin e veprimtarisë tregtare;
- ç) në rastet e pavlefshmërisë së themelimit të shoqërisë, të parashikuara nga neni 3/1 i këtij ligj;
- d) në raste të tjera, të parashikuara në statut;
- dh) në raste të tjera, të parashikuara me ligj;
- e) për çdo shkak tjetër të vendosur nga asambleja e ortakëve.

---

*Shorey*

*[Signature]*

Në këtë rast asambleja e ortakëve merr vendim me shkrim në të cilin parashikon mënyrën e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar 1 apo disa likuidatorë dhe shënuar në çdo dokument të nxjerrë prej tij emrin e likuidatorit dhe emërtesën shtese “ Shoqëri në likuidim e sipër “.

Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.

Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve.

Nëse Ortakët nuk marrin një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t’i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

### Neni 20

Likuiduesi merr përsipër të drejtat dhe detyrimet e administratorëve nga data e emërimit të tij.

Nëse shoqëria emëron më shumë se një likuidues, përveçse kur akti i emërimit parashikon se ata veprojnë veçmas njëri-tjetrit, likuiduesit ushtrojnë bashkërisht të drejtat e detyrimet sipas këtij ligji. Likuiduesit mund të autorizojnë njërin prej tyre të kryejë veprime të një kategorie të posaçme.

Kufizimet e tagrave të likuiduesve u kundrejtohen të tretëve, në përputhje me përcaktimet e ligjit.

Likuiduesi u nënshtrohet mbikëqyrjes së ortakut dhe administratorit.

### Neni 21

#### Të drejtat e detyrimet e likuiduesit

1. Detyra e likuiduesve është mbyllja e të gjitha veprimeve të shoqërisë, mbledhja e kredive të paarkëtuara dhe e kontributeve të pashlyera, shitja e pasurive të shoqërisë dhe shlyerja e kreditorëve duke respektuar radhën e referimit, sipas nenit 605 të Kodit Civil.
2. Likuiduesi mund të kryejë edhe veprime të reja tregtare, për mbylljen e një veprimi të papërfunduar.
3. Nëse, në bazë të padive të ngritura nga kreditorët, sipas nenit 194 të ligjit “ Per Tregtaret dhe Shoqërite Tregtare “, likuiduesit vërejnë se pasuria e shoqërisë tregtare, përfshirë kontributet e pashlyera, nuk është e mjaftueshme për pagesën e këtyre pretendimeve, likuiduesit detyrohen ta pezullojnë procedurën e likuidimit e t’i kërkojnë gjykatës përkatëse nisjen e procedurave të falimentimit.

Likuiduesi përgatit një bilanc të gjendjes së shoqërisë në çastin e hapjes së likuidimit dhe një bilanc përfundimtar në çastin e mbylljes së këtyre procedurave. Nëse procedura e likuidimit zgjat më shumë se një vit, likuiduesi përgatit, gjithashtu, pasqyrat financiare vjetore të shoqërisë. Bilancet në shoqëritë kolektive dhe komandite miratohen nga ortakët e tjerë, ndërsa në shoqëritë aksionare apo nga ato me përgjegjësi të kufizuar miratohen nga asambleja e përgjithshme.



**Neni 22**  
**Përfundimi i likuidimit**

Pas shpërndarjes së aktiveve të mbetura, likuiduesi e njofton Qendrën Kombëtare të Biznesit për përfundimin e likuidimit dhe kërkon çregjistrimin e shoqërisë, në përputhje me seksionin V të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit”

**Neni 23**  
**Bashkimi**

Dy ose më shumë shoqëri mund të bashkohen nëpërmjet:

1. Kalimit të të gjitha aktiveve e pasiveve të njëres ose më shumë prej shoqërive, që quhen shoqëritë e përthithura, të një shoqëri tjetër ekzistuese, e quajtur shoqëria përthithëse, në këmbim të aksioneve apo kuotave të kësaj shoqërie. Ky proces quhet bashkim me përthithje.
2. Themelimit të një shoqërie të re, tek e cila kalohen të gjitha aktivët e pasivët e shoqërive ekzistuese, që bashkohen në këmbim të aksioneve apo kuotave të shoqërisë së re. Ky proces quhet bashkim me krijim i një shoqërie të re.

**Neni 24**  
**Ndarja**

1. Një shoqëri mund të ndahet me vendim të Ortakëve, duke transferuar të gjitha aktivët e pasivët e veta në favor të dy ose me shumë shoqërive ekzistuese apo të themeluara rishtazi. Shoqëria që ndahet, vlerësohet e prishur.
2. Për ndarjen e shoqërisë zbatohen përkatësisht dispozitat e neneve 216 deri në 225 të ligjit 9901 date 14.04.2008..
3. Shoqëritë, që fitojnë pasuritë e shoqërisë që ndahet, quhen shoqëri pritëse dhe përgjigjen në mënyrë solidare për detyrimet e kësaj të fundit.
4. Regjistrimi i ndarjes së shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit ka si pasojë:  
kalimin të shoqëritë pritëse të të gjitha aktiveve e pasiveve të shoqërisë që ndahet, në përputhje me raportin e ndarjes, të përcaktuar në marrëveshjen e ndarjes. Ky kalim sjell pasoja për marrëdhëniet ndërmjet shoqërive, si dhe për palët e treta;  
bërjen e aksionarëve/ortakëve të shoqërisë që ndahet aksionarë apo ortakë të një ose më shumë shoqërive pritëse, në përputhje me raportin e ndarjes, përcaktuar në marrëveshjen e ndarjes;  
vlerësimin e shoqërisë që ndahet si e prishur dhe çregjistrimin e saj nga Qendra Kombëtare e Biznesit, sipas seksionit V të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit” pa kryerjen e likuidimit.

---

---

*Shoqëri*



**Neni 25**  
**Shndërrimi**

Shoqëria mund ta ndryshojë formën e vet ligjore, nëpërmjet shndërrimit të saj në shoqëri aksionare

Shndërrimi nuk sjell pasoja mbi të drejtat e detyrimet, që shoqëria ka marrë përsipër ndaj të tretëve.

**Neni 26**  
**Baza Ligjore**

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e tij në përputhje të plote me këto statut dhe dispozitat e legjislatcionit shqiptar.

Per sa nuk parashikohet në këto statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Per tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

**Neni 27**  
**Mosmarreveshjet**

Per mosmarreveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarreveshje që mund të lindë midis Shoqërisë dhe të tretëve, do të jete kompetente Gjykata Shqiptare.

**Neni 28**  
**Dispozita perfundimtare**

Ky Statut u redaktua në 4 ekzemplare me vlera të njëjta juridike në gjuhën shqipe, dhe nënshkruhet me vullnetin e tyre të lirë nga ortakët themelues.

Unë, Noterja ia lexova këtë Akt Themelimi me zë të lartë palëve, të cilat e gjetën atë në përputhje të plotë me vullnetin e tyre. Ky Akt Themelimi nënshkruhet lirish nga palët në praninë time, dhe unë Noterja, vërtetoj nënshkrimet e tyre sipas ligjit.

**ORTAKËT**

**AJET RAMÇAJ**

*Ajet Ramçaj*

**BOJANA RAMÇAJ**

*Bojana Ramçaj Blay*

**AJAN RAMÇAJ**

*Ajan Ramçaj*

**NOTERE**

**MARGALINA Y. DAUTI**

